



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:133270

Datë: 15.07.2024

Numri i dokumentit: 05937102

Ac.nr.5919/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari Hidajete Gashi Alaj kryetare e kolegjit, Faton Ademi dhe Besnik Bislimaj anëtarë, në çështjen juridike të paditëses M.SH nga Rahoveci, të cilën e përfaqëson Avokat I.K nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurit M.H nga Rahoveci, për shkak të kthimit të sendeve –kompensimin e dëmit, vlera e kontestit 3,070,00 euro duke vendosur në lidhje me ankesën e paditëses të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë –Dega në Rahovec, C.nr.118/2018, i datës 23.02.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.07.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditëses M.SH nga Rahoveci, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë –Dega në Rahovec, C.nr.118/2018, i datës 23.02.2021, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin C.nr.118/2018, i datës 23.02.2021 ka vendosur si në vijim:

*“REFUZOHET padia dhe kërkesëpadia e paditëses M.SH nga Rahoveci, me të cilën ka kërkuar që të “ OBLIGOHET i padituri M.H nga Rahoveci, që paditëses M.SH nga Rahoveci, t’ia kthejë sendet e saj: 10copa lira të arit në vlerë prej 2,000 €, një putli nga ari në vlerë prej 400 €, dy bilezika nga ari në vlerë prej 120 €, një qafore prej arit në vlerë prej 250 €, tre unaza prej arit në vlerë prej 250 €, tre unaza prej arit në vlerë prej 250 €, një kollan prej argjendi në vlerë prej*

*300 €, një çarçaf i mirë ngjyrë të kuqe në vlerë prej 100 €, 20 copa kanace – peshkirë në vlerë prej 100 €, 8 copa bohça në vlerë prej 64 €, 2 çarçafa të gavruar në vlerë prej 60 € dhe dhoma e fjetjes ( rregall, kauç etj.) në vlerë prej 1,000 €, të mbetura tek ai ose të paguaj paditëses shumën prej 3,070 €, Gjithashtu gjykata të obligojë të paditurin ti paguaj të gjitha shpenzimet procedurale në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm” SI E PA BAZË.*

*Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.”*

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit të paraparë ligjor ankesë ka parashtruar paditësja përmes përfaqësuesit të autorizuar, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe ta anuloj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ashtu që çështjen ta kthej në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

-Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës, vërtetohet se paditësja ka parashtruar padi me datë 12.02.2009 pranë Gjykatës së shkallës së parë me objekt kontesti kthim i sendeve, më konkretisht me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas padisë së paditësit, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe pas vlerësimit dhe administrimit të provave në shkresat e lëndës ka marrë aktgjykimin, C.nr.49/2009, i datës 08.05.2015 duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, dhe duke vendosur më decidivisht sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Pala e paditur e pa kënaqur me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit e cila me aktvendimin, Ac.nr.3079/15, i datës 08.03.2018 e ka aprovuar ankesën e të paditurit dhe e ka prishë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë duke ia kthyer lëndën të njëjtës në rishqyrtim dhe vendosje.

Pas kthimit në rigjykim, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe pas vlerësimit dhe administrimit të provave në shkresat e lëndës ka marrë aktgjykimin, C.nr.118/2018, i datës 23.02.2021 duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditëses, dhe duke vendosur më decidivisht sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar ka theksuar se duke i vlerësuar deklaratimet e ndërgjyqësve dhe në bazë të bindjes së vetë të lirë, është konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar dhe e njëjta është refuzuar.

Tutje ka shtuar se paditëses M.SH pasi që i është tërhek vërejtja që të flasë të vërtetën me pasojat juridike ashtu që e njëjta ka deklaruar se në ditën kritike pas dhunës të ushtruar nga ish bashkëshorti i saj këtu i padituri dhe nga jeta e padurueshme ka shkuar tek babai i saj dhe me vete i ka marrë dhe fëmijët dhe normalisht nuk ka pasur afat kohor që të marrë as veshmbathjet për vete por kam arritur vetëm ti marrë dy parë pizhamet për fëmijët. Pra të gjitha dhuratat para martesore dhe martesore më gjerësisht të përshkruara në padi i ka lënë në dhomën e të paditurit. E ritheksoj se dhuratat e saj kanë qenë 10 lira, një putli, dy belezikë, një qafore të artë, tre copa unaza, një kollan nga argjendi të gjitha këto atë kohë kanë pasur vlerë në shumë prej 3,070.00 Euro, kjo deklaratë e saj mund të vërtetohet edhe me deklaratën e dëshmitarëve N.E dhe me deklaratën e dëshmitarit R.K më shumë nuk din se çka të deklaronte.

Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se sipas dispozitës së nenit 7.1 të LPK-së, është paraparë se *“palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë provat me të cilat vërtetohen faktet e tilla”*, e bazuar në provat si dhe nga dëgjimi i palëve në procedurë, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar dhe në ri procedurë përfaqësuesi i autorizuar i paditëses gjykatës nuk i ofroi asnjë provë të re me të cilën do ta bindte gjykatën që të vendosë në favor të paditëses, në anën tjetër duke u bazuar në Aktvendimin e Gjykatës së Apelit që e ka prishur vendimin e kësaj gjykatë në këtë çështje kontestimore respektivisht në vërejtjet e dhëna për vendosje në këtë çështje, palët duhet ti ofrojnë prova të reja me të cilat do të vërtetohet kërkesëpadia e paditëses, gjithashtu gjatë seancës së datës 23.02.2021 paditësja dhe përfaqësuesi i saj ishin të luhatshëm lidhur me numrin e lirave të arit, andaj të njëjtën e ka refuzuar, duke e marrë parasysh paditësja nuk ka mundur të argumentoj se ekzistojnë gjësendet tek i padituri.

Gjykata e Apelit e Kosovës e pranon vlerësimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktgjykimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar drejtë, ndërsa e drejta materiale është zbatuar gabimisht.

Kolegji i Gjykatës së Apelit duke i vlerësuar pretendimet ankimore të palës paditëse vlerëson se edhe pse aktgjykimi është goditur për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, nga përmbajtja e ankesës nuk rezulton të jetë dhënë asnjë arsye e vetme se përse pala paditëse konsideron se aktgjykimi është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, andaj kjo Gjykatë meqenëse nuk ka gjetur se ekzistojnë shkelje për të cilat kujdeset sipas detyrës zyrtare, nuk do të lëshohet më tutje lidhur me këtë pretendim ankimor.

Sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit vlerëson se as këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë pasi që Gjykata e shkallës së parë pas administrimit

të provave të cilat i kanë paraqitur palët ndërgjyqëse drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike ashtu që nuk ka qenë kontestuese se paditësja dhe i padituri kanë jetuar së bashku dhe kanë konsideruar se kanë qenë të martuar ani pse martesë nuk ka qenë e lidhur asnjëherë pranë organit kompetent, mirëpo ky fakt nuk është kontestuar asnjëherë nga ana e palëve ndërgjyqëse. Kontestuese në këtë çështje juridike kontestimore ka qenë fakti se a kanë ekzistuar sendet të cilat paditësja ka pretenduar se duhet ti kthehen si dhe a ekziston e drejta e kompensimit të dëmit ashtu siç ka pretenduar pala paditëse me anë të padisë.

Gjykata e Apelit e mbështet në tërësi vendimin dhe përfundimin e Gjykatës së shkallës së parë kur e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses pasi që nga provat e ofruara pranë Gjykatës së shkallës së parë e të cilat gjenden edhe në shkresat e lëndës nuk rrjedh se kërkesëpadia e paditëses ka pasur bazë për tu aprovuar si e themeltë. Nga deklaratat e dëshmitarëve të cilat edhe vetë paditësja i ka propozuar që të dëgjohen e të cilët dëshmitarë i përmend edhe në ankesën e parashtruar duke pretenduar se nga dëshmitë e tyre do të vërtetohej themelësia e kërkesëpadisë, për Gjykatën e Apelit këto pretendime nuk mund të qëndrojnë pasi që nga leximi i deklaratave të të dy dëshmitarëve në asnjë mënyrë nuk janë vërtetuar pretendimet e palës paditëse me padi. Të dy dëshmitarët vetëm kanë deklaruar se palët ndërgjyqëse kanë qenë në bashkësi martesore dhe se paditëses me rastin e fejesës dhe martesës, ndërsa dëshmitari R.K ka deklaruar se nuk mund të deklarohet në mënyrë taksative për gjësendet sikurse edhe janë kërkuar me padi. Ndërsa nxjerrja e provës me ekspertizë

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të gjitha pretendimet e palës paditëse lidhur me sasinë e arit dhe gjësendeve të tjera që i ka kërkuar kanë mbetur vetëm në nivelin deklarativ pasi që e njëjta nuk ka mundur këto pretendime ti vërtetojë me asnjë provë të vetme. Sa i përket sendeve të tjera si kanë qenë peshqirë, bohça, çarçafa të gavruar etj., i padituri asnjëherë nuk i ka kontestuar ekzistimin e tyre dhe se vazhdimisht ka qenë i gatshëm që t'ia dorëzojë paditëses.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë provat me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa me dispozitat e nenit 319.1 të LPK , parashihet se secila palë ndërgjyqës ka për detyrë ti provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Në këtë drejtim, Gjykata e Apelit vlerëson se me vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale. Në rastin konkret nuk është arritur që të vërtetohet se paditëses në ndonjë formë i është shkaktuar dëm, andaj rrjedhimit edhe vendimi lidhur me refuzimin e kërkesëpadisë për këtë Gjykatë është i drejtë dhe i pranueshëm.

Gjykata i shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore por të njëjtat ishin pa ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që u vendos në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata drejtë ka vendos drejtë edhe në raport me shpenzimet e procedurës kontestimore. Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 pika (d) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2019:133270  
Datë: 15.07.2024  
Numri i dokumentit: 05937102

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.5919/2021, me datë 04.07.2024

Kryetare e kolegjit  
Hidajete Gashi Alaj, d.v.